



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 664/24 Dt. 28.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formim të Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike të aplikuesve të cilët kanë bërë kërkesë (aplikuar) në bazë të thirrjes publike të datës 19.08.2024 në projektin: “Furnizim me materiale ndërtimore për ndërtimin/renovimin e shtëpive të rastërve skamnore dhe në vështirësi ekonomike”. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

1. Dren Kryeziu, 2. Enver Kryeziu, 3. Albulena Pulaj, 4. Qendrim Berisha, 5. Erza Badallaj, 6. Festim Shendeti, 7. Elhame Berisha, 8. Arsim Tahiri, 9. Ebubeker Terzi.
 - Detyrat e Komisionit do të jenë: të bëj verifikimin dhe evidentimin e aplikuesve të cilët kanë bërë kërkesë (aplikuar) në pajtim me thirrjen publike për projektin: “Furnizim me materiale ndërtimore për ndërtimin/renovimin e shtëpive të rasteve skamnore dhe në vështirësi ekonomike”, dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
 - Obligohet Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Komisionit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

